

## **ANTONETA DHIMA**



**Datëlindja:** 05.12.1970

**Vendlindja:** Fier

**Email:** Antoneta.Dhima@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Ka përfunduar studimet në Akademinë e Forcave Tokësore në shkollën “Skënderbej”, dega Plan-Financë. Gjithashtu ka kryer studime pasuniversitare si vlerësuese e pasurive të paluajtshme. Po ashtu ka mbaruar studimet Master në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, në degën Ekonomi–Biznes. Në vitin 2012 ka marrë titullin “Kontabilist i miratuar” pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Nga viti 1993 deri në vitin 2004 ka qenë Shefe Finance në Repartet Ushtarake të qytetit Fier dhe Vlorë. Në vitet 2005–2006 ka qenë Drejtore e Financë–Buxhetit në Bashkinë Fier. Ka qenë Drejtore e Spitalit Rajonal Fier, në vitet 2013-2015. Gjithashtu në vitet 2006-2013 ka ushtruar detyrën e Drejtoreshës së Përgjithshme Ekonomike në Bashkinë Fier. Në vitet 2006 – 2011 ka qenë mësuese e jashtme në shkollën e mesme ekonomike jo publike “Alen”, Fier. Ka qenë mësuese e jashtme dhe në shkollën e mesme ekonomike jo publike “Flatrat e dijes” Fier.

Ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit për problemet praktike të kontabilitetit, standardet e kontabilitetit, financat vendore, administrimin e rrjeteve informatike, sistemin e taksave, buxhetimin me pjesëmarrje, menaxhimin e pronave publike, trajnime për funksionet e përbashkëta dhe të deleguara, përkatësinë gjinore dhe buxhetin, integrimin gjinor në politikat publike në nivel lokal, menaxhimin spitalor.

Znj. Dhima është pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste si dhe ka qenë aktive pranë strukturave drejtuese të PS që prej vitit 2005 e në vazhdim.

Nga viti 2015 e në vijim ka qenë deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Legjislaturën VIII dhe IX-të.